



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Punëve të Brendshme/Ministartvo Unutrašnjih Poslova/Ministry
of Internal Affairs

INSTITUTI I KOSOVËS PËR ADMINISTRATË PUBLIKE
INSTITUT KOSOVA ZA JAVNU ADMINISTRACIJU
KOSOVO INSTITUTE FOR PUBLIC ADMINISTRATION



HCDF

Në bashkëpunim me Projektin KSV 019
Asistenca Teknike në kontekst të Integritimit
implementuar nga ZKM dhe financuar nga
Qeveria e Luksemburgut

Instituti i Kosovës për Administratë Publike (IKAP) mbështetur nga Projekti ‘KSV/019 Mbështetje Teknike në Kontekst të Integritimit Evropian të Kosovës’ bazuar në Udhëzimin Administrativ (QRK) - Nr. 13/2018 për Kushtet, Angazhimin, Kategorizimin dhe mënyrën e pagesës së trajnerëve në Institutin e Kosovës për Administratë Publike shpall:

THIRRJE PËR APLIKIM

Ftohen të interesuarit të cilët plotësojnë kriteret e kërkuara sipas legjislacionit në fuqi për trajnimin e trajnerëve, të aplikojnë për ligjërues/trajnerë të ardhshëm për zbatim të këtij programi:

Trajnim për Trajnerë (TpT): Trajnim për trajner për të Drejtat e Pronësisë Industriale

Programi do të përfshijë pjesën teorike dhe praktike lidhur me kornizën ndërkombëtare dhe vendore me fokus në standardet e BE-së duke përfshirë aftësitë e nevojshme, njohuritë për politikën dhe zbatimin e të Drejtave të Pronësisë Intelektuale në BE dhe obligimet nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit për vendin tonë.

Qëllimi i këtij programi është që të rritë kapacitetet e zyrtarëve dhe të krijoj nga ta një grup trajnerësh të cilët do të mund të bartin njohuritë e zyrtarëve të institucioneve publike në lidhje me politikën, legjislacionin dhe zbatimin në praktikë të të drejtave të pronësisë industriale.

Kandidatët që kalojnë me sukses programin e trajnimit, do të certifikohen në mënyrë që të mund të ofrojnë trajnime në këtë fushë.

Kohëzgjatja dhe koha e mbajtjes së programit të trajnimit

Programi i trajnimit për trajner do të zgjasë katër ditë. Pjesa e parë e trajnimit, konkretisht trajnimi për trajner, tentativisht do të mbahet **në javën e parë të muajit Prill**.

Vlerësimi i kandidatëve:

Në harmoni me Udhëzimin administrativ të lartcekur, të gjithë kandidatët për trajnerë do të vlerësohen gjatë përzgjedhjes dhe pas përfundimit të trajnimit.

Aplikacionet vlerësohen në bazë të kriterëve si në vijim:

- Arsimimi dhe kualifikimi profesional;
- Përvoja e punës në fushën adekuate;

- Përvoja në ofrimin e trajnimeve;
- Elementet tjera të meritës duke përfshirë hulumtimet dhe përvoja në fushën përkatëse.

Angazhimi i trajnerëve pas trajnimit:

Aplikantët që do të rezultojnë të suksesshëm dhe në bashkëpunim me IKAP-in do të mund angazhohen si trajner në kuadër të trajnimeve të ofruara nga IKAP.

Afati kohor për dorëzimin e aplikacioneve **15 mars 2022 deri më 29 mars 2022**. Numri i kandidatëve që do të për zgjidhen për të vijuar trajnimin është i limituar.

Kandidatët e interesuar duhet të dërgojnë vetëm **CV (formati Europass)** dhe një letër motivimi (deri në **250 fjalë, në formën bashkëlidhur**) në mënyrë elektronike në gjuhën shqipe, në email adresën: Besart.Mulaj@rks-gov.net, duke specifikuar emërtimin e programit për të cilin aplikojnë.

Të gjitha kualifikimet dhe dëshmitë e përmendura në Aplikacionin tuaj mund të kërkohen për verifikim.